



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 209

8 janar

2014

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Ligj nr. 175/2013 datë 12.12.2013	Për një ndryshim në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar.....	9233
Ligj nr. 176/2013 datë 16.12.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.....	9233
Vendim i Kuvendit nr. 66/2013, datë 24.12.2013	Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”.....	9234
Vendim i Kuvendit nr. 67/2013, datë 24.12.2013	Për ngritjen e nënkomisionit “Për çështjet e të miturve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë	9234
Vendim i Kuvendit nr. 68/2013, datë 24.12.2013	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”	9235
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shaqir Nedreu	9236
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Roland Gjyli	9236

LIGJ
Nr. 175/2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.3.2005, “PËR MËNYRËN DHE
PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE PËR DËRGIMIN E FORCAVE
USHTARAKE SHQIPTARE JASHTË VENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, 78, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 19, pikat 2 dhe 3, fjalët “Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për transportin”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.12.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8453, datë 30.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 176/2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9948, DATË 7.7.2008, “PËR SHQYRTIMIN E
VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN
BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përfundon më 30 qershor 2016.”.



Neni 2

Në nenin 16 të ligjit nr. 58/2012, që ndryshon ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, fjalët “dhe bie nga fuqia më 31 dhjetor 2013” hiqen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.12.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8454, datë 30.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM Nr. 66/2013

PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH “PËR NGRITJEN E NJË KOMISIONI HETIMOR PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE, SI DHE PËR TË NJOHUR DHE VERIFIKUAR NË THELLËSI FENOMENIN E NDËRHYRJES DHE BLOKIMIT PËR DISA DITË TË SISTEMEVE ELEKTRONIKE TATIMORE”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”, për shkak se objekti i punës së këtij komisioni është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës, si dhe me interpretimet që Gjykata Kushtetuese ka bërë në vendimet e saj me nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 24.12.2013

VENDIM Nr. 67/2013

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR ÇËSHTJET E TË MITURVE, BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 1, 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për çështjet e të miturve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është monitorimi i politikave qeveritare në mbështetje të gruas dhe familjes, me synim zhvillimin ekonomik dhe social, në harmoni me mirëqenien e individëve, realitetet e reja të tregut të punës, problemet e përmirësimit dhe respektimit të të drejtave të gruas dhe fëmijëve në sfidat e jetës së përditshme, si dhe përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në këtë proces.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|------------------|-------|
| 1. Olta Xhaçka | Kryetare | (PS) |
| 2. Liljana Elmazi | Zëvendëskryetare | (PD) |
| 3. Klodiana Spahiu | Anëtare | (PS) |
| 4. Andrea Marto | Anëtar | (PS) |
| 5. Bujar Kllogjri | Anëtar | (LSI) |
| 6. Albina Deda | Anëtare | (PD) |
| 7. Voltana Ademi | Anëtare | (PD) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 24.12.2013

VENDIM
Nr. 68/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 48/2013 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, neneve 55, pika 1 dhe 21, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Republikane,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Fatmir Mediu caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 24.12.2013



VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 377, datë 27.12.2013, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Shaqir Nedreu.

KËRKESË

Shtetasja Danjela Zhura e datëlindjes 8.10.1993, lindur në Bilisht dhe banuese në Korçë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Roland Gjyli.

KËRKUESE
Danjela Zhura

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë